



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.29, datë 01.08.2023

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:

“KOMPLEKS BANIMI, HOTELERIE ME SHËRBIME 1, 25, 39 DHE 50 KATE MBI
TOKË DHE 3 KATE PARKIM NËNTOKË, NË RRUGËN “TEODOR KEKO”, ME
VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të neneve, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqëritë “Xh & M” sh.p.k, “Alfazed” sh.p.k dhe “Smart Construction Invest” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Kompleks banimi, hotelerie me shërbime 1, 25, 39 dhe 50 kate mbi tokë dhe 3 kate parkim nëntokë, në rrugën “Teodor Keko, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë”, me subjekt zhvillues shoqëritë “Xh & M” sh.p.k, “Alfazed” sh.p.k dhe “Smart Construction Invest” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë, bashkëlidhen si pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Vendimi Nr.20, datë 03.12.2020 i Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin: Kompleks banimi, hotelerie dhe shërbimesh 1, 2, 16 dhe 17 kate, me 2 kate parkimi nëntokë, në rrugën “Teodor Keko”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë”, shfuqizohet.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGISË
BELINDA BALBUKE



SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELA JDA ROKA



Nënshkruar më datë 18/04/2024